

1. DOKUMENTACIONI I NEVOJSHËM PËR ANËTARËSIM NË URDHRIN E FARMACISTËVE (Kur nuk ushtron profesionin)

Çdo farmacist që kërkon të anëtarësohet në Urdhrin e Farmacistëve të Shqipërisë (UFSH) duhet të paraqitet personalisht në Këshillin Rajonal përkatës me dokumentet e mëposhtme.

- Kërkesë për anëtarësim në Urdhrin e Farmacistëve të Shqipërisë sipas formatit të miratuar nga Këshilli Kombëtar.
- Fotokopje e Diplomës Universitare dhe listës së notave të noterizuara (Farmacistët të cilët diplomohen jashtë Republikës së Shqipërisë dhe shtetasit e huaj duhet të paraqesin njësimin e diplomës së tyre në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, fotokopje të përkthyer dhe të noterizuar të diplomës dhe listës së notave dhe/ose fotokopje të përkthyer dhe noterizuar të vërtetimit të kryerjes së provimit të shtetit)
- Të jenë shpallur fitues në provimin e shtetit në dokumentin zyrtar të ardhur nga AKP
- Fotokopje e kartës së identitetit ose pasaportës.
- Tre fotografi 3 x 3.5 cm.
- Mandat pagesa për tarifën e regjistrimit 1500 lekë.
- Çertifikatë të gjendjes civile nëqoftëse ka ndryshime të të dhënave personale. (ndryshim emri/mbiemri)

1/1. DOKUMENTACIONI I NEVOJSHËM PËR ANËTARËSIM DHE LEJE TË USHTRIMIT TË PROFESIONIT SI FARMACIST I PUNËSUAR

Në rastin e aplikimit për çertifikatë si i punësuar, aplikuesi përveç gjithë dokumentave të paraqitura në pikën 1, duhet gjithashtu të sjellë:

- Fotokopje të kartës së anëtarësisë (nëse ka qënë më parë anëtar I UFSH pa ushtruar profesionin)
- Vetëdeklarim sipas formatit të miratuar nga Këshilli Kombëtar.
- Kontratë pune me punëdhënësin
- Fotokopje e ekstraktit historik të QKR të subjektit farmaceutik të 3 muajve të fundit.
- Fotokopje e QKL.
- Fotokopje e Çertifikatës së Urdhrit të drejtuesit teknik të subjektit farmaceutik ku do të punësohet.
- Gentplan dhe planvendosje të objektit ku do të ushtrohet profesioni.
- Deklarata e pronarit të subjektit farmaceutik sipas nenit 19 të Statutit të UFSH (nëse pronari është jofarmacist).
- Mandatpagesën për lejen e ushtrimit të profesionit 5000 lekë.